

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA PYJORE E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **203/40300-26-5414-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizimin me uniforma dhe këpucë verore për nevojat e APK-së.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SOLID SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Zona Industriale p.n., Shirokë

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

044/113393

(Numri Telefonit)

(Kodi postar)

23000

Nuk aplikohet

(Numri i Faks-it)

Shfqet Kuqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


Solidshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

24.08.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti Kontraktues: Agjencia Pyjore e Kosovës; procedura: e hapur, e ndarë në dy lote.

Publikimi: Njoftimi për Kontratë (B05) është publikuar në platformën e-prokurimi më 13.07.2026; korrigjimet B54 janë publikuar më 17.07.2026 dhe 23.07.2026.

Afati dhe hapja: 24.08.2026, ora 14:00; dorëzimi përmes platformës e-prokurimi dhe hapja në APK, Rr. Hamdi Mramori nr. 10, Prishtinë.

Kriteri i dhënies: tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Nuk aplikohet. Ankesa paraqitet para hapjes së tenderëve dhe kundërshton kërkesat e Dosjes së Tenderit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Më 14.08.2026, “Solid” Sh.P.K. parashtroi pranë Autoritetit Kontraktues kërkesë për rishqyrtim kundër kërkesave të Dosjes së Tenderit, para hapjes së tenderëve. Me vendimin e datës 19.08.2026, AK e refuzoi kërkesën si të pabazuar dhe nuk aprovoi as ndryshimin e Dosjes së Tenderit, as zgjatjen e afatit për dorëzimin e tenderëve.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit

Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar (LPP):

- Neni 1 - Qëllimi;
- Neni 7 - Barazia në trajtim/jo-diskriminimi;
- Neni 27 - Dosja e Tenderit;
- Neni 28 - Specifikimet teknike;
- Neni 51- Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes;
- Neni 53 - Sigurimi i informatave shtesë;
- Neni 66 - Përshtatshmëria profesionale;
- Neni 67 - Provat shkresore; dhe
- Neni 69 - Aftësia teknike dhe/ose profesionale.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. HYRJE

1. “Solid” Sh.P.K. (tutje: Ankuesi) është operator ekonomik dhe prodhues vendor i interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me nr. 203/40300-26-5414-1-1-1. Për përgatitjen e ofertës, dokumentacionit dhe mostrave, Ankuesi duhet të njohë paraprakisht dhe me saktësi kërkesat e kualifikimit, dokumentet dëshmuese dhe karakteristikat teknike që do të përdoren gjatë vlerësimit.
2. Më 14.08.2026, brenda fazës para hapjes së tenderëve, Ankuesi parashtroi kërkesë për rishqyrtim lidhur me: (i) kërkesën e joproportionale për ISO/IEC 27001:2022, (ii) formulimin e pasaktë të kërkesës për ISO 20347:2022 si certifikim i prodhuesit; dhe (iii) mungesën e parametrave të matshëm për këpucët verore, krahas kërkesës që mostrat të jenë identike me fotografitë. Me vendimin e datës 19.08.2026, AK i refuzoi të gjitha pretendimet.

II. BAZA LIGJORE PËR APROVIMIN E ANKESËS

a. Pretendimi i parë: kërkesa për ISO/IEC 27001:2022 nuk është drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës

3. Në pikën 7.1 dhe 7.2, kërkesa nr. 4, Dosja e Tenderit kërkon që prodhuesi, për të dy lotet, të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO/IEC 27001:2022 dhe ISO 45001:2018. ISO/IEC 27001:2022 përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, përfshirë sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e informacionit. Lënda e kontratës është furnizimi me uniforma dhe këpucë verore. Dosja nuk identifikon asnjë proces, sistem informativ, përpunim të të dhënave ose rrezik të sigurisë së informacionit që do ta bënte këtë certifikim të nevojshëm për prodhimin apo furnizimin e mallrave të kërkuara. Si e tillë kjo kërkesë nuk mund të konsiderohet e ligjshme dhe e arsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit.
4. Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kriteri është vendosur “në funksion të sigurimit të kapaciteteve dhe standardeve të prodhuesit” është pohim i përgjithshëm. Ai nuk tregon se cilin detyrim kontraktual, cilën karakteristikë të uniformës ose këpucës, apo cilin rrezik konkret të ekzekutimit e mbulon ISO/IEC 27001:2022. Sipas nenit 51 paragrafi 3 dhe nenit 69 paragrafi 1 të LPP-së, kriteri dhe dëshmia duhet të jenë drejtpërdrejt relevante, proporcionale dhe të nevojshme për lëndën e kontratës. Vendosja e kriterit nga AK nuk e zëvendëson detyrimin për ta arsyetuar këtë lidhje objektive.
5. AK e ka zhvendosur gabimisht barrën te Ankuesi, duke kërkuar që ai të provojë se kriteri është i pamundur për t’u përmbushur ose se favorizon një operator të identifikuar. Cenimi i konkurrencës ekziston edhe kur një kriter i panevojshëm përjashton ose dekurajon prodhues të aftë që mund ta ekzekutojnë kontratën, por nuk mbajnë një certifikim të pandërlidhur me mallrat. Për më tepër, kriteri është vendosur te “përshtatshmëria profesionale”, ndonëse Neni 66 i LPP-së e lidh këtë kategori me regjistrimin, autorizimin ose licencimin profesional, jo me një sistem të sigurisë së informacionit. Prandaj, kërkesa duhet të hiqet për të dy lotet.

b. Pretendimi i dytë: Dosja e tenderit dhe vendimi i Autoritetit Kontraktues japin dy kuptime të ndryshme për ISO 20347:2022

6. Në pikën 7.1 dhe 7.2, kërkesa nr. 5, Dosja përcakton: “*Prodhuesi duhet të jetë i certifikuar me standardin ISO 20347 2022 për Lot pjesa-2*”, ndërsa si dëshmi kërkon “Kopje e certifikatës ISO 20347 2022”. Ky formulim e paraqet standardin si certifikim të prodhuesit. Ankuesi ka kundërshtuar pikërisht këtë pasaktësi, sepse standardi lidhet me kërkesat dhe përputhshmërinë e produktit në këtë rast të këpucëve profesionale dhe jo me certifikimin e sistemit të menaxhimit të prodhuesit.
7. Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, vetë Autoriteti Kontraktues e ndryshon kuptimin e kërkesës duke deklaruar se “*dokumentacioni i paraqitur nga prodhuesi për dëshmimin e përputhshmërisë së produktit me ISO 20347:2022 do të shqyrtohet në fazën e vlerësimit*”. Pra, Dosja kërkon certifikim të prodhuesit, kurse vendimi flet për dëshmi të përputhshmërisë së produktit. Kjo nuk është përgjigje ndaj pretendimit, por është konfirmim se formulimi i Dosjes është i pasaktë dhe kërkon korrigjim serioz.
8. Lënia e kësaj çështjeje për fazën e vlerësimit nuk e mënjanon paqartësinë. Tenderuesit duhet të dinë para dorëzimit nëse kërkohet certifikatë për prodhuesin, certifikatë apo raport për modelin konkret të këpucës, deklaratë përputhshmërie, cili organ duhet ta lëshojë dokumentin dhe si trajtohen dëshmitë ekuivalente. Pa këtë saktësi, AK ruan diskrecion prapaveprues për të pranuar një formë dokumenti e për të refuzuar një tjetër, në kundërshtim me nenet 7, 27, 28, 51 dhe 69 të LPP-së. Kërkesa duhet të riformulohet në Dosje dhe në njoftim përmes B54, duke përcaktuar qartë standardin e synuar, produktin për të cilin kërkohet përputhshmëria dhe dëshminë e pranueshme.
- c. Pretendimi i tretë: specifikimet e këpucëve verore nuk janë të matshme dhe bien ndesh me kërkesën për mostër “identike” me fotografinë**
9. Aneksi 1 e përshkruan artikullin si “këpucë operative të lehta për përdorim në terren”, ndërsa fotografia e paraqitur tregon një model të thellë ose gjysmë të thellë që mbulon kyçin e këmbës. Njëkohësisht, Dosja kërkon dorëzimin e mostrave dhe paralajmëron refuzimin e ofertës nëse mostra nuk është identike me fotografinë dhe me kërkesat teknike. Kur fotografia përdoret si kriter detyrues për refuzim, ajo nuk mund të trajtohet vetëm si ilustrim, raporti ndërmjet fotografisë dhe përshkrimit tekstual duhet të jetë i qartë dhe objektiv dhe të ekzistojnë përshkrime apo vizatime teknike të cilat e përshkruajnë modelin dhe lejonjë prodhuesit ta prodhojnë mostrën sipas kërkesave të qarta të autoritetit. Në fazën siç është aktualisht, lë të nënkuptohet se autoriteti e favorizon një version të një prodhuesi i cili e ka të gatshme këtë produkt.
- 10.
11. Dosja nuk përcakton parametra të domosdoshëm që ndikojnë drejtpërdrejt në modelin, funksionin, koston dhe krahasueshmërinë e produktit, përfshirë:
- (i) lartësinë e këpucës, të matur nga pjesa e brendshme shkelëse deri në pjesën e sipërme;
 - (ii) nëse materiali kërkohet të jetë lëkurë apo material sintetik dhe, nëse kërkohet lëkurë, trashësinë minimale;
 - (iii) konstruksionin dhe numrin e shtresave të pjesës ajrosëse, si dhe nëse kërkohet hidrorezistencë;

(iv) trashësinë dhe përbërjen e tabanit, përfshirë nëse kërkohet gomë e plotë apo material TR; dhe

(v) llojin e përforsimit në pjesën e gishtërinjve.

10. Vendimi refuzues thotë se këto parametra nuk janë të nevojshëm, por nuk shpjegon se si do të vlerësohet objektivisht “identiteti” i mostrës me fotografinë pa dimensione, toleranca ose karakteristika të matshme. Përgjigjja se nuk kërkohet mbrojtje metalike ose plastike e gishtërinjve është, në vetvete, sqarim material që duhej t’u komunikohet të gjithë operatorëve dhe të përfshihej formalisht në Dosje.

11. Referimi i Ankuesit në aktivitetin paraprak nuk paraqitet si bazë për riformulimin e kësaj dosje. Në të kundërtën ne si operator përballemi me rrezikun praktik të interpretimit të ndryshëm të fotografisë dhe përshkrimit. Shkelja në aktivitetin aktual qëndron te fakti se operatorët duhet të prodhojnë ose sigurojnë mostër nën kërcënimin e refuzimit, pa ditur paraprakisht cilat karakteristika objektive do të konsiderohen detyruese. Kjo cenon trajtimin e barabartë dhe mundësinë për konkurrencë efektive.

12. Vendimi i datës 19.08.2026 nuk është bindës dhe nuk përmbush elementet detyruese të një akti administrativ, nevojshmërisë dhe proporcionalitetit. Për ISO/IEC 27001:2022, AK vetëm përsërit kërkesën pa treguar lidhjen me kontratën. Për ISO 20347:2022, AK e riinterpreton kërkesën nga certifikim i prodhuesit në përputhshmëri të produktit, por refuzon ta korrigjojë Dosjen. Për specifikimet teknike, AK nuk pajton mospërputhjen ndërmjet përshkrimit të përgjithshëm dhe fotografisë detyruese, as nuk përcakton mënyrë objektive të vlerësimit të mostrave. Rrjedhimisht, refuzimi është i pabazuar dhe lë në fuqi kritere e specifikime që nuk mund të zbatohen në mënyrë transparente dhe të barabartë.

Duke u bazuar në faktet, provat dhe dispozitat e lartcekura, Ankuesi i propozon OSHP-së që nxjerr këtë:

VENDIM

I. **APROVOHET** si të bazuar ankesën e “Solid” Sh.P.K. dhe **ANULOHET** Njoftimi për kontratë i Autoritetit Kontraktues e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimin me uniforma dhe këpucë verore për nevojat e APK-së. të datës 19.08.2026 mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim” me numër: 203/40300-26-5414-1-1-1.

II. **DETYROHET** Autoritetin Kontraktues që ta korrigjojë Dosjen e Tenderit dhe njoftimin për kontratë: (a) duke e hequr ISO/IEC 27001:2022 nga kërkesat për të dy lotet; (b) duke e hequr kërkesën për ISO 20347:2022 si dëshmi të përputhshmërisë së produktit; dhe (c) duke i plotësuar parametrat e matshëm të këpucëve verore dhe duke qartësuar raportin ndërmjet specifikimit tekstual dhe fotografisë;

III. **DETYROHET** Autoriteti Kontraktues që, pas publikimit të korrigjimeve, ta zgjasë afatin për dorëzimin e tenderëve në përputhje me LPP-në, në mënyrë që operatorët të kenë kohë të mjaftueshme për përgatitjen e dokumenteve dhe mostrave; dhe

IV. Të vendos OSHP për kthimin e tarifës së ankimit sipas nenit 118 të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

N/a

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura